


Njihuni me **Anëtarët e rinj të Bordit**





Armend Bekaj

Kryesues i Bordit

Armendi, i cili ishte anëtar aktiv dhe i përkushtuar i Bordit të KCSF-së, tani ka marr rolin e Kryetarit të Bordit, duke sjellë me vete mbi dy dekada përvojë ndërkombëtare në fushën e demokracisë, paqes dhe sigurisë.

Aktualisht shërben si hulumtues në Departamentin për Kërkime mbi Paqen dhe Konfliktin në Universitetin e Uppsala-s në Suedi. Më herët, Armendi ka mbajtur pozita të larta në Fondacionin Dag Hammarskjöld si Menaxher i lartë për Paqe dhe Siguri dhe në International IDEA si Zyrtar i lartë i Programit për Vlerësimin e Demokracisë, të dyja këto me seli në Suedi.

Gjatë gjithë karrierës së tij, ai ka bashkëpunuar me institucione udhëheqëse globale, përfshirë OS-BE-në, USAID-in, UNDP-në, Kombet e Bashkuara dhe IDLO-n, duke avancuar nisma që nxisin qeverisjen demokratike dhe paqen e qëndrueshme.

Me ekspertizën, vizionin dhe përkushtimin e tij të thellë ndaj zhvillimit demokratik të Kosovës, lidershipi i Armendit do të jetë i paçmuar në udhëheqjen e misionit të KCSF-së për forcimin e shoqërisë civile dhe promovimin e demokracisë në Kosovë dhe më gjerë.



Adnan Čerimagić *Anëtar i Bordit*

Adnani është analist i lartë për Ballkanin Perëndimor në Iniciativën Evropiane për Stabilitet (ESI), ku udhëheq hulumtimet dhe analizat e politikave mbi qasjen e BE-së ndaj rajonit. Me formim akademik në drejtësi dhe marrëdhënie ndërkombëtare të BE-së, ai sjell përvojë të gjerë në integrimin europian, diplomaci dhe të drejta të njeriut.

Karriera e tij përfshin punën në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Bosnjë dhe Hercegovinës, Parlamentin European dhe disa institucione kërkimore për të drejtat e njeriut, duke i dhënë atij një kombinim unik të njohurive në politikëbërje dhe ekspertizë rajonale.

Jemi të lumtur që Adnani i bashkohet Bordit tonë dhe presim me kënaqësi perspektivën e tij strategjike mbi integrimin në BE dhe ndikimin e tij në shoqërinë civile dhe politikëbërjen në Ballkanin Perëndimor.

Përkushtimi i tij ndaj vlerave demokratike, të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimit rajonal do të jetë një aset i madh për misionin e KCSF-së për avancimin e demokracisë dhe forcimin e shoqërisë civile në Kosovë dhe më gjerë.



Bridget Millman

Anëtare e Bordit

Bridget sjell me vete mbi 15 vjet përvojë në avancimin e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe shoqërisë civile në mbarë botën. Në rolin e saj aktual në National Endowment for Democracy, ajo mbikëqyr një portofolio globale të programeve që fuqizojnë qytetarët aktiv, nxisin pjesëmarrjen demokratike dhe mbrojnë liritë themelore.

Më parë, Bridget ka punuar në German Marshall Fund of the United States, duke pasur në fokus Ballkanin Perëndimor. Gjatë gjithë karrierës së saj, ajo ka punuar ngushtë me një gamë të gjerë partnerësh, duke kontribuar në përpjekjet që promovojnë të drejtat e njeriut dhe forcojnë qeverisjen e përgjegjshme.

Bridget ka formim akademik në shkenca politike dhe zhvillim ndërkombëtar.

Ekspertiza, lidershipi dhe përkushtimi i thellë i Bridget ndaj zhvillimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të shoqërisë civile i kontribuon misionit të KCSF-së drejt forcimit të demokracisë në Kosovë.



Brikenda Rexhepi *Anëtare e Bordit*

Brikenda ka qenë një zë kyç në peizazhin medial të Kosovës që nga viti 1998 dhe aktualisht shërben si kryeredaktore në KOHA.

Karriera e saj përfshin përvojë të gjerë në raportim, menaxhim lajmesh dhe zhvillim medial, si dhe angazhim në media ndërkombëtare, si Radio France Internationale si dhe në Departamentin e Mediave të OSBE-së gjatë tranzicionit të mediave pas luftës në Kosovë.

Përtej gazetarisë, Brikenda ka kontribuar në punë akademike dhe kërkimore në fushën e gjuhësisë dhe ka ligjëruar në Universitetin e Prishtinës.

Për ne është nder të kemi në Bordin e KCSF-së leadershipin, integritetin dhe përkushtimin e thellë të saj ndaj mediave të pavarura dhe llogaridhënies publike.

Ekspertiza e saj mbi komunikimin publik dhe përkushtimi i palëkundur ndaj së vërtetës dhe transparencës do të jenë vlera të paçmueshme në avancimin e misionit të KCSF-së për forcimin e demokracisë dhe hapësirës qytetare në Kosovë



Ertan Munoglu

Anëtar i Bordit

Ertani është përfaqësues i Helvetas në Kosovë, ku menaxhon Projektin për Decentralizim dhe Mbështetje Komunale dhe shërben si Këshilltar Rajonal për Qeverisje të Mirë, duke sjellë më shumë se dy dekada përvojë në demokratizim, qeverisje lokale dhe reforma institucionale.

Sfondi i tij i larmishëm përfshin bashkëpunimin me UNDP-në, GLZ-in, Zyrën e BE-së në Kosovë, Asociacionin e Komunave të Kosovës, Action Against Hunger dhe Agjencinë Evropiane për Rindërtim.

Krahas punës së tij profesionale, Ertani ka qenë aktiv edhe në kërkime akademike dhe mësimdhënie, përfshirë ligjërimin mbi Integrimin European dhe reformën e administratës publike.

Ekspertiza e tij e gjerë në qeverisje, nga kuptimi i thellë i zhvillimit institucional dhe nga përkushtimi i tij i fortë për ndërtimin e institucioneve transparente, llogaridhënëse dhe të orientuara drejt qytetarëve, që avancojnë demokracinë dhe besimin shoqëror në Kosovë.